

## Inhaltsverzeichnis

Vorwort .....	1
Hinweise für den Benutzer .....	3
Wörterverzeichnis .....	7
Anhang: Kurzer Überblick über das deutsche Rechnungswesen (Albanisch) .....	275
Literaturverzeichnis .....	287

### Bibliografische Information Der Deutschen Bibliothek

Die Deutsche Bibliothek verzeichnet diese Publikation in der Deutschen Nationalbibliografie; detaillierte bibliografische Daten sind im Internet über <http://dnb.ddb.de> abrufbar. ISBN 3-87548-385-5

© Helmut Buske Verlag GmbH, Hamburg 2005. Alle Rechte, auch die des auszugsweisen Nachdrucks, der fotomechanischen Wiedergabe und der Übersetzung, vorbehalten. Dies betrifft auch die Vervielfältigung und Übertragung einzelner Textabschnitte durch alle Verfahren wie Speicherung und Übertragung auf Papier, Transparente, Filme, Bänder, Platten und andere Medien, soweit es nicht §§ 53 und 54 URG ausdrücklich gestatten. Druck und Verarbeitung: Druckhaus „Thomas Müntzer“, Bad Langensalza. Werkdruckpapier: alterungsbeständig nach ANSI-Norm resp. DIN-ISO 9706, hergestellt aus 100% chlorfrei gebleichtem Zellstoff. Printed in Germany.

*www.buske.de*

---

## Vorwort

Im Rahmen der Intensivierung der wirtschaftlichen Beziehungen zwischen der Bundesrepublik Deutschland und dem albanischsprachigen Balkanraum (Albanien, Kosovo und Westmazedonien) sind der Umgang mit den Wirtschaftsbegriffen der deutschen Sprache sowie deren richtige Auslegung von vorrangiger Bedeutung. Diese Aufgabe übernimmt das Wirtschaftswörterbuch Deutsch-Albanisch mit rund 25.000 Wörtern und Redewendungen aus diversen Wirtschaftsbereichen, wie Bank- und Börsenwesen, Buchführung und Bilanzierung sowie aus den damit verbundenen Bereichen wie Verwaltung, Wirtschaftsprivatrecht, Versicherungswesen, Spedition und Bahn- und Seetransportwesen. Das Wörterbuch, für dessen Erarbeitung moderne deutsche, englische und italienische Wirtschaftslexika herangezogen wurden, dient in erster Linie den Interessenten der deutschen Wirtschaftssprache, Studenten der Betriebswirtschaftslehre, Fachleuten sowie Übersetzern.

Die schwunghaften Entwicklungen in der postkommunistischen Zeit in Albanien in Richtung Marktwirtschaft gingen mit grundlegenden Veränderungen auch in den Wirtschaftswissenschaften einher. Die Übernahme und teilweise Anpassung der Wirtschafts-, Rechts- und Steuerstandards aus den Ländern der Europäischen Union brachte eine Fülle von neuen Wörtern, Redewendungen und Begriffen, die in der albanischen Fachliteratur in verschiedenen Formen vorzufinden sind. Es sind genau diese wirtschaftlichen und sprachlichen Umstände sowie spezifischen Aspekte der deutschen Wirtschaft in den Buchführungs-, Steuer- und Börsenbereichen, welche zum steigenden Schwierigkeitsgrad der Übersetzung vieler Wirtschaftsbegriffe beigetragen haben.

An dieser Stelle möchte ich mich bei meiner Ehefrau Elke für die Korrekturen der Wörter, Herrn Dr. jur. Günther Schatz für die Hilfe bei der Erklärung spezifischer wirtschaftsprivatrechtlicher Termini, Richter Wolfgang Stoppel für die Bereitstellung des albanischen Gesetzesmaterials sowie bei Prof. Dr. Bardhyl Demiraj für die sprachwissenschaftlichen Beratungen bedanken.

Für Kritik, Bewertungen, Vorschläge und Ergänzungen, für welche ich sehr dankbar bin, wenden Sie sich bitte an die elektronische Postadresse dritan.halili@gmx.de. Vielen Dank.

Dritan Halili

---

## Parathënie

Në kuadrin e intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe hapësirës ballkanike shqipfolëse (Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë Perendimore) është me rëndësi të dorës së parë kuptimi dhe mirëinterpretimi i koncepteve ekonomike të gjuhës gjermane. Këtë detyrë merr përsipër fjalori ekonomik gjermanisht-shqip me rreth 25.000 fjalë dhe shprehje nga fusha të ndryshme të ekonomisë, si ato të bankës, bursës, kontabilitetit, bilancimit dhe të fushave të lidhura me to, si ato të administratës, drejtësisë ekonomike, sigurimit, transportit rrugor, hekurudhor e detar. Ky fjalor, për përpilimin e të cilit u konsultuan fjalorë modernë ekonomikë gjermanisht, anglisht dhe italisht, i shërben në radhë të parë të interesuarve për gjuhën ekonomike gjermane, studentëve të ekonomisë, ekspertëve, si dhe përkthyesve.

Zhvillimet e vullshme në periudhën paskomuniste në Shqipëri në rrugën drejt ekonomisë së tregut u shoqëruan me ndryshime themelore edhe në shkencat ekonomike. Marrja dhe përshtatja e pjeshme e standardeve ekonomike, juridike dhe fiskale prej vendeve të Bashkimit Evropian kanë përcjellë një mori fjalësh, shprehjesh dhe termash të reja që në literaturën ekonomike shqiptare përdoren në forma nga më të ndryshmet. Janë pikërisht këto kushte të mjedisit ekonomikogjuhësor në Shqipëri, si dhe aspektet specifike të ekonomisë gjermane në fushën e kontabilitetit, hartimit të bilancit, tatimeve dhe të bursës që ndikuan në rritjen e shkallës së vështirësisë së përkthimit të shumë termave ekonomikë.

Me këtë rast dëshiroj të falënderoj bashkëshorten time Elke për korrigjimet në fjalor, zotin dr. Gynter Shac (Günther Schatz), Doktor i Shkencave Juridike, për ndihmën në sqarimin e termave specifike ekonomikogjuridike, gjykatësin Wolfgang Shtopel (Wolfgang Stoppel) për vënien në dispozicion të materialit ligjor shqiptar, si dhe prof. dr. Bardhyl Demirajn për këshillimet shkencore-gjuhësore.

Për kritika, vlerësime, sugjerime, plotësime, për të cilat unë u jam shumë mirënjohës, ju lutem drejtohuni në adresën e postës elektronike dritan.halili@gmx.de. Shumë faleminderit.

Dritan Halili

## A

- à (nd.) | **la Baisse** *F. bur.* spekulon për ulje (të kurseve); **einen Betrag ~ conto zahlen** paguan një shumë në llogari; ~ **ein Euro** një euro për copë (çmimi); ~ **la Hausse** *F. bur.* spekulon për ngritje (të kurseve); ~ **jour** *F.* për ditë.
- ab** prej; ~ **Fabrik (Werk)** prej fabrikës; ~ **Lieferungsdatum** prej datës së livrimit.
- ab•ändern** ndryshon, modifikon.
- Abänderung** (f.) **eines gekreuzten Schecks in einen Barscheck** ndryshim i çekut me viza të hequara në një çek me pagesë në dorë.
- Abandonerklärung** (f.) deklaratë dorëheqjeje.
- Abbau** (m.) 1 shkurtim pakësim, ulje, 2 çmontim, 3 heqje, largim, 4 nxjerrje (minerali); ~ **der Auftragspolster** ulje e gjendjes së porosive të mbledhura; ~ **der Handelsschranken** heqje e barrierave tregtare; ~ **von Personal** shkurtim personeli; ~ **der Preisüberwachungsvorschriften** heqje e rregullave për kontrollin e çmimit; ~ **der Zölle** ulje e doganave.
- ab•bauen** (fo.) 1 shkurton, pakëson, ul, 2 heq, largon, çmonton.
- ab•bestellen** (fo.) 1 ndërpret, 2 anulon porosinë, çporosit; **Ware** ~ anulon porosinë e mallit; **Zeitung** ~ ndërpret pajtimin në gazetë.
- Abbestellung** (f.) 1 ndërprerje, 2 anulim porosie, çporositje.
- ab•bezahlen** (fo.) paguan me këste.
- ab•brechen** (fo.) 1 ndalon, ndërpret, 2 prish; **Streik** ~ ndalon grevën; **Verhandlungen** ~ ndërpret bisedimet.
- Abbröckeln** (a.) **der Kurse** *bur.* rënie e kurseve.
- ab•bröckeln** (fo.) *bur.* bie; **Notierungen** ~ bien kuotimet.
- Abbruch** (m.) 1 ndërprerje, 2 prishje, shkatërrim; ~ **baulicher Anlagen** prishje e ndërtesave (pa leje); ~ **der Verhandlungen** ndërprerje e bisedimeve; ~ **arbeiten** (sh.) punime të prishjes; ~ **preis** (m.) çmimi i prishjes.
- abbruchreif** (mb.) i amortizuar plotësisht, gati për t'u prishur.
- Abbruch(s)unternehmen** (a.) ndërmarrje e prishjes së objekteve.
- ab•buchen** (fo.) *ban.* tërheq (nga llogaria e klientit), debiton.
- Abbuchung** (f.) *ban.* tërheqje (nga llogaria), debitim; **vom Konto des Kunden eine ~ über 1000,- € vornehmen** kryen një tërheqje prej mbi 1000,- € nga llogaria e klientit.
- Abbuchungsauftrag** (m.) urdhërxhirim; ~ **verfahren** (a.) procedurë e debitimit direkt.
- ABC-Analyse** (f.) analizë ABC.
- ab•decken** (fo.) mbulon; **durch eine Hypothek** ~ mbulon me hipotekë.
- Abdeckung** (f.) *ban.* mbulim; ~ **eines Kredites** mbulim i një kredie; ~ **von Schulden** mbulim i detyrimeve.
- Abdiskontierung** (f.) = Abzinsung.
- ab•disponieren** (fo.) *ban.* transferon; **Gelder** ~ transferon fondet; **Vermögenswerte** ~ transferon elementet pasurore.
- Abdruck** (m.) 1 *adm.* kopje, letër e shtypur, bocë, 2 riprodhim; **erster** ~ kopje e parë.
- ab•drucken** (fo.) shtyp, faqos.
- Abend|ausgabe** (f.) edicion i mbrëmjes; ~ **börse** (f.) bursë e mbrëmjes; ~ **kasse** (f.) biletari e mbrëmjes; ~ **zeitung** (f.) gazetë e mbrëmjes.
- Aberkennung** (f.) | **des Ruhestands** privim i pensionit; ~ **von Schaden(s)ersatz** privim i dëmshpërblimit.
- ab•fahren** (fo.) nisët (automjeti etj.).
- Abfahrt** (f.) nisje.
- Abfahrt(s)|bahnsteig** (m.) *hek.* peron i nisjes; ~ **rampe** (f.) platformë e nisjes; ~ **signal** (a.) sinjal i nisjes; ~ **zeit** (f.) orë e nisjes, orar i nisjes.
- Abfall** (m.) 1 mbetje teknologjike, skorrje, 2 rënie, ulje, 3 mbeturina, plehra; ~ **der Leistungen** ulje e rezultateve.
- ab•fallen** (fo.) 1 mbetet tepër, ngel tepër, 2 bie, ulet.
- Abfall|material** (m.) material mbeturinë; ~ **produkt** (a.) 1 produkt i prodhuar nga mbetje teknologjike, 2 produkt skarco; ~ **verwertung** (f.) ripërdorim i mbetjeve, riciklim i mbetjeve; ~ **wirtschaft** (f.) ekonomi e riciklimit të mbetjeve teknologjike (pjesë e drejtimit dhe kontrollit të materialeve).
- ab•fangen** (fo.) kap, zë; **Kunden** ~ zë një klient.
- ab•fassen** (fo.) 1 formulon, përpilon, shkruan, 2 redakton; **freundlich** ~ shkruan me përzemërsi.
- Abfassung** (f.) | **einer Beschwerde** përpilim i një ankese; ~ **eines Reklametextes** përpilim i tekstit të një reklame.
- ab•fertigen** (fo.) 1 përgatit (për nisje), 2 kryen

(formalitetet), 3 trajton keq, 4 zhdoganon; **Güterverkehr** ~ zhdoganon mallrat; **Kunden** ~ trajton keq klientin; **Passagiere** ~ kryen formalitetet e pasagjerëve; **Schiff** ~ përgatit anijen për nisje.

**Abfertigung** (f.) 1 përgatitje (për nisje), 2 dispeçeri (spedicioni), 3 kryerje (formalitetesh), 4 zhdoganim; **zollamtliche** ~ kryerje e zhdoganimit; ~ **von Waren** zhdoganim i mallrave; ~ **von Zollgut** zhdoganim i mallrave me doganë; ~ **zum freien Verkehr beantragen** dog. bën kërkesë për bërjen gati për qarkullim (të mallrave).

**Abfertigungsdienst** (m.) shërbim i doganës; ~ **gebühr** (f.) hek. taksë e ngarkim-shkarkimit; ~ **schalter** (m.) dog. sportel i kontrollit; ~ **schein** (m.) fletë e zhdoganimit; ~ **stelle** (f.) zyrë e doganës; ~ **zeit** (f.) 1 kohë e kryerjes së formaliteteve (në aeroport), 2 kohë e përgatitjes për nisje (të mallit).

**abfinden** (fo.) kompenson, dëmshpërblen; **jdn. in bar** ~ kompenson dikë me para në dorë.

**Abfindung** (f.) dre. kompensim; ~ **für die Entlassung** kompensim për pushimin nga puna; ~ **für die Kündigung des Vertrages** kompensim për prishjen e kontratës.

**Abfindungsbetrag** (m.) shumë e kompensimit; ~ **zahlung** (f.) pagesë e kompensimit.

**abflachen** (fo.) bie, ulet (cilësia, prodhimi, niveli etj.).

**Abflauen** (a.) | **des Interesses** ulje e interesit; ~ **der Kurse** bur. ulje e kurseve; ~ **der Konjunktur** rënie e koniunkturës; ~ **der Preise** ulje e çmimeve.

**abflauen** (fo.) bie, ulet.

**Abflug** (m.) nisje e aeroplanit; ~ **hafen** (m.) aeroport i nisjes së aeroplanit; ~ **halle** (f.) sallë e pritjes së aeroplanit; ~ **zeit** (f.) orë e nisjes së aeroplanit.

**Abfluss** (m.) rrjedhje, dalje, humbje; ~ **des Kapitales ins Ausland** dalje e kapitalit jashtë vendit.

**abführen** (fo.) fis. paguan, dorëzon; **an das Finanzamt die Umsatzsteuer** ~ paguan tatimet mbi xhiro në zyrën e tatimeve.

**Abfuhr** (f.) 1 fis. dorëzim, pagim, 2 transport; ~ **der Lohnsteuer** pagim i tatimeve mbi roqë; ~ **von Müll** transport i plehrave.

**Abgaben** (sh.) 1 taksa, tatime, kontribute, dorëzime (term i përgjithshëm), 2 bur. shitje; **frei von** ~ pa taksë, çliuroi nga taksat; **allgemeine** ~ taksa të përgjithshme (tatime, dogana); **besondere** ~ taksa të veçanta (taksa, kontribute); **drückende** ~ taksa të rënda; **große** ~ **an der**

**Börse** shitje të mëdha në bursë; **öffentliche (staatliche)** ~ taksa publike (shtetërore); **soziale** ~ kontribute të sigurimeve shoqërore; ~ **erheben** vjel taksat; **hohe** ~ **bezahlen** paguan taksa të larta.

**Abgabeneigung** (f.) bur. prirje për të shitur.

**abgabe(n)|frei** (mb.) pa taksa, pa tatime; ~ **pflichtige** (mb.) **Ware** mall për t'u tatuar.

**Abgabenordnung (AO)** (f.) kodi tatimor; ~ **pflichtiger** (m.) i detyruar për të paguar taksë; ~ **wirtschaft** (f.) ekonomi fiskale.

**Abgabe|preis** (m.) 1 çmim i shitjes (së gazit, së elektricitetit etj.), 2 bur. çmim i emisionit (të titujve); ~ **termin** (m.) ditë e dorëzimit.

**Abgang** (m.) 1 nisje, 2 ulje, pakësim, 3 humbje, firo, 4 shitje; **reißenden** ~ **finden** shitet shpejt; ~ **der Lagermenge durch Verkauf** pakësim i sasisë së magazinuar nëpërmjet shitjes; ~ **durch höhere Gewalt** humbje nga fuqi madhore; ~ **durch Verschrottung** humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit (e makinerisë).

**Abgänge** (sh.) 1 kon. pakësime, 2 humbje, firo, 3 largime (personeli); ~ **des Anlagevermögens** pakësime të aktiveve të qëndrueshme; ~ **einer Ware** firo e një malli.

**Abgangs|bahnhof** (m.) hek. stacion i nisjes; ~ **hafen** (m.) port i nisjes; ~ **zeit** (f.) orë e nisjes.

**abgeben** (fo.) jep, dorëzon; **blanko** ~ **ban.** dorëzon në të bardhë (titullin bankar); **Einkommenssteuerklärung** ~ dorëzon deklaratën tatimore; **sein Gepäck** ~ dorëzon valixhen; **Wechsel** ~ dorëzon një kambial.

**abgehen** (fo.) 1 shitet, 2 ulet, zbritet, 3 nisët, 4 firon; **davon 2%** ~ prej kësaj zbritet 2%; **nur langsam** ~ shitet ngadalë; **reißend** ~ shitet shpejt; **vom Gewicht** ~ firon prej peshës.

**abgehend|e** (mb.) **Ladung** ngarkesë që po nisët; ~ **er Zug** tren që po nisët.

**abgehoben** **ban.** i tërhequr (nga llogaria); ~ **er Betrag** shumë e tërhequr.

**Abgeld** (a.) = Disagio.

**abgelten** (fo.) paguan, kompenson; **Kapitalertragsteuer durch einen 30%-igen Pauschalbetrag** ~ paguan tatimet e fitimit nga kapitali nëpërmjet një shume aforfë prej 30%; **Überstunden** ~ paguan për orët shtesë të punës.

**Abgeltung** (f.) pagim, kompensim.

**abgemachter** (mb.) **Preis** çmim i rënë dakord.

**abgerechnet** (mb.) 1 i zbritur, 2 i llogaritur; ~ **er Betrag** shumë e llogaritur, shumë e zbritur.

**abgerundet|er** (mb.) **Betrag** shumë e rumbullakosur; ~ **e Zahlung** pagesë e rumbullakosur.

**abgeschlossen|es** (mb.) **Börsengeschäft** transak-